



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2022:279341

Datë: 19.04.2024

Numri i dokumentit: 05595750

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-Dega Kaçanik, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar individual, me sekretaren juridike Azemine Berisha, duke vendosur në çështjen juridike të paditësi E. S. , nga fshati ... Komuna Kaçanik, të cilën me autorizim e përfaqëson M. K. B., avokate nga Kaçaniku , kundër të paditurës KS "...", me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson E. A., me autorizim, për çështjen juridike kontestuese kompensim i dëmit, në seancën kryesore të mbajtur me datën 20.03.2024, në praninë e të autorizuarve të palëve ndërgjyqësve, ndërsa me datën 19.04.2024, bëri përpilimin me shkrim të këtij:

**A K T G J Y K I M**

**I. MIRATOHET**, kërkesëpadia e paditësit E. S. , nga fshati ..., Komuna Kaçanik dhe **DETYROHET**, e paditura Kompania e Sigurimeve "...", me seli në Prishtinë, që paditësit, të ja kompensoj dëmin jo material dhe material, të pësuar si pasojë e lëndimeve të shkaktuara, në aksidentin e komunikacionit të datës 25.05.2022, edhe atë:

**I/a Dëmi jo material për:**

Dhimbje trupore -fizike shumën.....4,000.00 €

Frikën e shkaktuar shumën .....3,000.00 €

**I/b Dëmin material për:**

Ndihmën dhe për kujdesin e huaj.....420.00€

Ushqim të përforcuar.....	200.00€
Shërim rehabilitues.....	300.00€
Shpenzimet materiale për shërim dhe rehabilitim .....	70.00€

Gjithsej shumën prej.....7.990.60€

Të gjitha këto shuma me kamatë, prej 8% duke filluar prej datës 20.03.2024,(data e seancës kryesore) e deri në pagesën definitive.

**II. DETYROHET** pala e paditur, që paditësit, t'ia paguaj shumat e gjykuara në pikën I. të këtij dispozitivi, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumë prej 1,073.00€, të cilat pagesa do të bëhen në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit në dorëzim, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

### A r s y e t i m

E autorizuar e paditësit, si në padi ashtu në seancat e mbajtura, ka theksuar se më datën 125.05.2022, rreth orës 14:31 minuta, në fshatin ... Komuna e Kaçanikut, ka ndodhur aksident i komunikacionit, ku lëndime trupore pëson paditësi E. S. , nga fshati ..., Komuna Kaçanik.

Tutje ka theksuar se aksidenti, është shkaktuar, kur të dy njësit kanë lëvizur, në relacionin Kaçanik-fshati ..., njësia një ndalet kur arrin përballë shtëpisë së H. T. dhe ndërmerr veprime jo të sigurta, pa u siguruar mirë se me këto veprime, rrezikon vetë dhe pjesëmarrësit tjerë në trafik, nuk e shikon këndin e errët, fillon kthimin në të majtë e kalon në shiritin e kundërt të lëvizjes, ku me pjesën e përparme të majtë godet në pjesën e pasme të majtë njësinë dy, e cila në këtë moment ishte në anashkalim të tij, ku përveç dëmeve materiale të dy njësive , lëndime trupore pëson drejtuesi i njësisë dy, tani paditësi.

Automjeti VW Golf, me ngjyrë të hirit, me targë të regjistrimit ..., të cilin e drejtonte S. T. nga fshati ..., ishte i siguruar tek e paditura , me policë të sigurimit .... Në këtë fatkeqësi paditësja ka pësuar lëndimi të rënd trupor, ky fakt është vërtetuar nga ekspertiza e grupit të ekspertëve mjekësor, të cilit kanë konstatuar se paditësi ka pësuar lëndime të rënd trupor edhe

atë: ndrydhje dhe përdredhje, i nyjës së zogut të shputës së majtë, ndrydhe dhe distorzion të gjurit të djathtë dhe krisje e kockës së fibulës së djathtë.

Po ashtu, si rezultat i këtij aksidenti dhe lëndimeve të pësuar, paditësi ka pësuar dhimbje fizike, frikë, kishte nevojë për kujdesin e personit tjetër, ushqim të përforcuar, rehabilitim dhe shpenzime materiale për shërim, fakte të vërtetuara nga ekspertiza mjekësore. Prandaj, duke i marr parasysh, këto fakte të konstatuara, ka kërkuar që kërkesëpadia e paditëses, të miratohet në tërësi si e bazuar si në precizimin e bërë me shkrim.

Shpenzimet i ka kërkuar.

E paditura, përmes të autorizuarës, si në përgjigje në padi, në seancat e mbajtura, bazën juridike të kërkesëpadisë nuk e ka kontestuar, por a theksuar se duke u bazuar në raportin e policisë, konsiderojmë se paditësi ka përgjegjësi në shkaktimin e aksidentit, për faktin se i njëjti ka tentuar të tejkalojë, veturën e ndalur para tij, pa u siguruar mirë, se a është vetura në lëvizje e sipër, po ashtu duke e vozitur mjetin pa leje adekuate duke paraqitur pengesa për pjesëmarrëset tjerë në komunikacion.

Po ashtu ka deklaruar se me kohë i ka pranuar, ekspertizën e ekspertit të komunikacionit, ndaj të cilës kanë vërejtje, por nuk ka sqarime dhe dëgjimin e ekspertit dhe nuk ka kërkuar nxjerrjen e ndonjë prove të re dhe i ka propozuar gjykatës, që të vazhdohet me leximin e provave dhe fjalën përfundimtare.

E autorizuara, po ashtu e ka kontestuar, precizimin e kërkesëpadisë, për nga lartësia, sepse shumat e kërkuar me precizim, janë shumë të larta dhe nuk janë në harmoni me kriteret e kompanive dhe praktikën gjyqësore.

Në fjalën përfundimtare i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit, ta aprovoj pjesërisht si të bazuar dhe gjykata ta refuzoj një pjesë të kërkesëpadisë duke u bazuar në faktin se shumat e kërkuara janë shumë të larta.

Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

Gjykata për ta vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në këtë çështje juridike civile me propozimin e palëve ndërgjyqësve e zhvilloi procedurën e provave duke e bërë leximin e këtyre provave të shkruara: U lexuan raporti i aksidentit, raporti i policit hetues, raporti i qendrës emergjente në Ferizaj, kuponët tatimor, raportet specialistike, raporti për terapi fizikale, ekstrakti nga regjistri qendror, përgjigja në padi, ekspertiza mjekësore, aktgjykimi i datës 14.03.2023 dhe ekspertiza e ekspertit të komunikacionit , pa vërejtje.

Pas analizimit të provave në tërësi dhe të secilës veç e veç si dhe konform nenit 8 të LPK-së dhe bindjes së lire të gjykatës, gjykata me këtë çështje kontestimore juridiko- civile vërtetoi këtë gjendje faktike:

Aksidenti i komunikacionit, ka ndodhur më datën 25.05.2022, është shkaktuar me lëshimet Automjeti të udhëtarëve “VW GOLF”, me targë të regjistrimit, ..., të cilin e drejtonte S. T.. Në këtë aksident lëndim të rënda trupore ka pësuar paditësi. Si rezultat i këtij lëndimi ka pësuar dhimbje fizike, frikë, ka pasur nevojë për ndihmën e personit tjetër , ushqim të përforcuar, rehabilitim klimaterik si dhe shpenzime materiale gjatë shërimit, fakte këto të cilat sipas nen.136, 159 dhe nen. 169 të LMD-ës, paraqesin bazë për kompensimin e dëmit.

a) Se aksidenti ka ndodhur me datën 25.05.2022, rreth orës 14:34 minuta, në rrugën e fshatit ..., këtë fakt gjykata e vërtetoi nga Raporti i aksidentit dhe Raporti i policit hetuesi të datës 25.05.2022, po ashtu ky fakt është vërtetuar edhe nga ekspertiza e ekspertit të komunikacionit, por ky fakt nuk ishte kontestues në mes të palëve ndërgjyqëse.

b)Se aksidenti është shkaktuar, me lëshimet e ngasësi i automjetit të udhëtarëve “VW GOLF”, me targë të regjistrimit, ..., të cilin e drejtonte S. T.. Këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga thëniet në padi, raporti i aksidentit, raporti i policit hetues, të datës 25.05.2022, ekspertiza e ekspertit të komunikacionit. Në ekspertizën e ekspertit të komunikacionit, është shënuar se i njëjti nuk është bindur se veprimin e kthimit majtas e banë në mënyrë të sigurt , nuk i ka marr masat e siguris për kthim majtas në mënyrë të sigurt, të shkoj në retrovizorin e majtë, dhe të shikoj në këndin e vdekur, nuk ka qen i kujdesshëm dhe i koncentruar gjatë kthimit majtas.

c) Se në këtë aksident, paditësi, ka pësuar lëndime të rënda trupor, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga ekspertiza e ekspertëve mjekësorë, të cilët kanë konstatuar se paditësi, ka pësuar ndrydhje dhe përdredhje, të nyjës së zogut të shputës së majtë, ndrydhje dhe distorzion të gjurit

të djathtë, krisje e kockës së fibullës së djathtë , të cilat lëndime klasifikohen, si lëndime të rënda trupore, por pa invaliditet të përhershëm jetësor. Pastaj si pasoj e këtij lëndimi, paditësi ka përjetuar dhimbje fizike, frikë, ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tret, ushqim të përforcuar, rehabilitim si dhe ka pasur shpenzime për shërim, fakte të cilat paraqesin bazë për kompensim.

Nga mendimi i ekspertëve mjekësor, është konstatuar se paditësi, si rezultat i këtij aksidenti, ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit të rëndë, që kanë zgjatur 3 ditë, kohë pas kohe, deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjeve. Dhimbje të intensitetit të mesëm, që kanë zgjatur për 21 ditë, kohë pas kohe sidomos gjatë kohë së nevojshme për të tërheqjen e dëmës primare kockore, nën veprimin e terapisë. Pastaj këto dhimbje kanë kaluar në dhimbje të intensitetit më të ulët, sipas të dhënave nga bashkëbisedimi me paditësin, ato janë prezentë sidomos gjatë ndryshimeve klimatike, , qëndrimit të gjatë në këmbë, këto janë fakte të cilat paraqesin bazë për kompensimin e dëmit.

Prandaj gjykata duke pas parasysh llojin e lëndimeve, vendin e lëndimit, moshën e paditëses, vështirësitë dhe situatat e pa-lakmueshme, të cilat e kanë përcjelle gjatë mjekimit, shqetësimet që ndodhin gjatë trajtimit mjekësor, e ka caktuar shumën prej 4.000.00€, e cila do të shërbej si satisfacion për dhimbjet e pësuar.

Nga mendimi i ekspertës së psikiatrisë Dr. N. M. -Psikiatër, e cila ka konstatuar se paditësi ka pësuar frikë primare, e cila ka zgjatur disa sekonda, në formë të frikës nga vdekja, dhe kërcënimit direkt për integritetin e tij fizikë. Pastaj kjo frikë ka kaluar në frikë sekondare të intensitetit të lartë që kanë zgjatur 2 ditë, e shoqëruar me gjendje të reagimit akute ndaj stresit, të përjetuar pas traumës fizike dhe lëndimit, ankthe gjatë natës, çrregullim gjumi, rikujtim të ngjarjes traumatike dhe reagime emocionale me të quajtura ngase ka qenë i kufizuar në aktivitete shoqërore nervozë, frik nga ime bashkëmohatarët e tij. Gjatë kësaj periudhe, paditësi është vizituar edhe tek psikiatri, i cili i ka përshkruar terapi përkatës anti depressive, për shkak të çrregullimit të stresit pas traumës.

Pastaj kjo frikë ka kaluar në frikë të intensitetit të mesëm, e cila ka zgjatur 1 muaj, e shoqëruar me çrregullim gjumi, ankthe me rikujtim të herëpashershme të ngjarjes traumatike, vështërsi të adaptimit me kushtet e trajtimit mjekësor, mungesë vetëbesimi dhe pasiguri, me indisponimin. Pastaj kjo frikë , ka kaluar në frikë sekondare të intensitetit të ulët, e cila ka zgjatur

për gjashtë muaj, është manifestuar me vështirësi të adoptimit në periudhën e rehabilitimit, nervozes shqetësimeve të herë pas hareshme, gjat gjumit, rënjes së dispononit dhe vetëbesimit, me pa sihuri sidomos gjatë pjesëmarrjes në komunikacion. Fakte këto të cilat paraqesin bazë për kompensim të dëmit. Prandaj gjykata duke pas parasysh kohëzgjatjen dhe intensitetin e frikës së pësuar, intensitetin e frikës, e cila është ekuivalente me lëndimet e marra trupore, llojin e lëndimit, moshën e paditësit, vendin e lëndimit e ka caktuar shumën prej 3.000,00 €.

Nga mendimi i grupit të ekspertëve, është konstatuar, se paditësi ka pasur nevojë, për ndihmën e personit tjetër, në kohëzgjatje prej 28 ditësh. Kjo ndihmë konsiston për kryerjen e disa aktiviteteve të përditshme jetësore, siç janë, ushqimi, veshmbathja, hixhiena dhe ndihma gjatë trajtimit mjekësor, e cila ndihmë është ofruar nga familjarët. Prandaj gjykata duke pasur parasysh nevojën e sajë për ndihmën e personit të tretë si dhe praktikën gjyqësore ka gjykuar shumën prej 420.00€, e cila shumë është adekuate dhe përkon me kriteret e kompanive, praktikë gjyqësore dhe koha e nevojshme për ndihmën e personit tjetër., .

Nga mendimi i grupit të ekspertëve, është konstatuar se paditësit, ju është nevojitur ushqimi i përforcuar, në kohë zgjatje prej 3 javë, i pasur me vitamina minerale, dhe albumina, ushqim i cili ndikon në rritjen e forcës imunitare të organizmit dhe konsolidimin më të shpejtë kockorë. Prandaj gjykata duke e pasur parasysh nevojën e tij për ushqim të përforcuar si dhe praktikën gjyqësore për këto raste, ka gjykuar shumën prej 200,00€, e cila shumë është adekuate dhe përkon me shpenzimet reale, që paditësja i ka pasur për marrjen e ushqimit të përforcuar gjatë periudhës së shërimit.

Nga mendimi i ekspertëve, është konstatuar se paditësi ka pasur nevojë për rehabilitim fizioterapeutik klimatik, në kohëzgjatje prej 15 ditëve, vitin e parë dhe 10 ditë tjera në vitin e dytë pas aksidentit me qëllim të rikthimit të masës dhe forcës muskulor edhe rritjen e amplitudës së lëvizjes në regjionin e zogut të shputës së majtë. Prandaj gjykata duke e pasur parasysh nevojën e tij për rehabilitim si dhe praktikën gjyqësore, për këto raste, ka gjykuar shumën prej 300,00€, e cila shumë është adekuate dhe përkon me shpenzimet reale, që paditësja i ka pasur për marrjen e terapisë fizikale.

Paditësi si rezultat, i këtij lëndimi, ka pasur edhe shpenzime materiale për shërim, e të cilat shpenzime janë bërë pa fajin e tij. Prandaj gjykata duke u bazuar në faturat e prezantuar të

cilat gjinden në shkresat e lëndës, sipas specifikacionit të shpenzimeve, e caktoi shumën prej 70,00€.

Gjykata pas analizimit të thënieve në padi, provave të bashkangjitura, raportit të aksidentit, raportit të policit hetues, përgjigjes në padi, ekspertizës së mjekësore dhe të komunikacionit, theksimeve të palëve ndërgjyqës, të bëra gjatë këtij procesi gjyqësor, kërkesëpadinë e paditëses, e miratoi në tërësi si të bazuar. Nga raporti i aksidentit, raporti i policit hetues dhe pretendimeve të palëve është vërtetuar se ky aksident, është shkaktuar me lëshimet e të siguruarit të paditurës, e ky fakte është pohuar edhe na pala e paditure, e cila bazën nuk e ka kontestuar.

Pastaj ky fakt është vërtetuar edhe nga ekspertiza e ekspertit të komunikacionit, i cili ka konstatuar se deri tek aksidenti ka ardhur me lëshimet e ngasësit të automjetit të udhëtarëve “VW GOLF”, me targë të regjistrimit, ..., të cilin e drejtonte S. T.. Në këtë ekspertizë eksperti i komunikacionit ka konstatuar se: i njëjti nuk është bindur se veprimin e kthimit majtas e banë në mënyrë të sigurt, nuk i ka marr masat e sigurisë për kthim majtas në mënyrë të sigurt, të shikoj në retrovizorin e majtë, dhe të shikoj në këndin e vdekur, nuk ka qen i kujdesshëm dhe i koncentruar gjatë kthimit majtas.

Pastaj nga ekspertiza mjekësore, është konstatuar se paditësi, ka pësuar lëndime të rëndë trupor, me fajin e të siguruarit të të paditurës, e ky fakt nuk ishte kontestues në mesë të palëve ndërgjyqëse.

Pastaj e paditura, kërkesëpadinë e paditësit nuk e ka kontestuar, për nga baza. Prandaj gjykata duke i pasur për bazë këto fakte të shënuara më lart, ka ardhur në përfundim se kompensimi i gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është i drejtë dhe real dhe në harmoni me praktikën gjyqësore. Po ashtu është në harmoni me udhëzuesin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës GJ.A 41/2023, i datës 27.02.2023.

Nga sa u theksua më lart, u vërtetua se paditësi, si pasoj e lëndimeve të shkaktuara, në fatkeqësinë e cekur më lart, ka pësuar dëm material dhe jo material në shumat e caktuara dhe përgjegjësinë për këtë dëm në rastin konkret e mban e paditura, nga baza e auto përgjegjësisë. Prandaj gjykata, konform dispozitave të neneve 136, 159, dhe 169, të LMD-së, me këtë gjendje

të vërtetuar faktike e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia kompensojë dëmin e pësuar në shumat e gjykuara sipas të gjitha bazave të pranuar.

Me dispozitën e nenit 136 par.1 të LMD-së është paraparë se kush i shkakton damë tjetrit ka për detyre ta kompensojë përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij, nga provat në shkresat e lëndës, është vërtetuar se dëmi është shkaktuar me fajin e të siguruarit të të paditurës.

Me dispozitën e nenit 159 të LMD-së, është paraparë, se në rast të aksidentit të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi, zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit. Me nenin 169 të LMD-së, është paraparë, se personi përgjegjës, ka për detyre ta rivendos gjendjen, e cila ka qene para se të shkaktohet dëmi, ndërsa në paragrafin 2, është paraparë në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të ja shpërblen në të holla.

Prandaj gjykata duke u bazuar në konstatimet e shënuara më lartë të ekspertëve, e duke u bazuar në nen.323 të LPK-së, në vlerësimin e lirë ka ardhur në përfundim se shumat e gjykuara në dispozitiv të këtij aktgjykimi, janë shuma reale dhe në përpjesëtim me dëmin e pësuar nga paditësja për shkak të dhimbjeve të përjetuara fizike, frikë, shëmtimit, zvogëlim të aktivitetit jetësorë, ushqim të përforcuar, ndihmës së personit të tretë, rehabilitim, ka pësuar dëm material, prandaj për të gjitha këto e caktoi kompensimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me propozimin e palëve ndërgjyqës. nuk i ka dëgjuar ekspertet mjekësorë dhe të komunikacionit, sepse edhe pala paditëse edhe pala e paditur, nuk e kanë kontestuar ekspertizën mjekësorë dhe të komunikacionit dhe i kanë propozuar gjykatës që të mos dëgjohen ekspertët. Prandaj gjykata duke pasur parasysh këto kërkesa të palëve ndërgjyqëse ka vepruar konform nenit 368 të LPK-së, ku është paraparë se seanca për shqyrtim kryesor mbahet edhe po që se eksperti nuk vjen në të, sepse palët kanë propozuar që të mos dëgjohen ekspertet sepse nuk kishin vërejtje as pyetje për ekspertet mjekësorë..

Meqenëse pala e paditur ka rënë në vonesë me kompensimin e dëmit. Gjykata me kërkesën e palës paditëse dhe në bazë të nen.382 të LMD-së, e detyroi të paditurën që paditësit



në shumat e gjykuara t'ia paguaj edhe kamatën vjetore prej 8% edhe atë duke filluar nga data 20.03.2024(data e seancës kryesore), e deri në pagesën definitive.

Gjykata i analizoi theksimet e palës paditëse, e cila i propozoj gjykatës që kërkesëpadinë ta miratoj në tërësi si të bazuar. Këto pretendime gjykata i analizoi dhe ua dha besimin dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Paditësi këtë dëm e ka pësuar pa fajin e tij, me fajin e të siguarit të paditurës dhe e paditura ka detyrim që ta paguaj dëmin të cilin e ka shkaktuar i siguruari i saj.

Personi, i cili e ka shkaktuar aksidentin, ka qenë i siguar tek e paditura me policë të sigurimit me nr,0007057551 e cila ka qen vlefshme deri me 27.04.2023 dhe ka ndodhur me fajin e tij, i cili fakt është vërtetuar nga aktgjykimi 2022:139876, i datës 14.03.2023, me të cilin është shpallur përgjegjës për kundërvajtjen e kryer nga neni 255 paragrafi 2 të Ligjit për rregullat e komunikacionit rrugor Ligji Nr. 05/L-088. Po ashtu nga ekspertiza e komunikacionit është konstatuar, sepse deri te aksidenti ka ardhur me lëshimet e të siguarit të paditurës.

Gjykata i analizoi edhe theksimet e të autorizuarit të paditurës, i cili i propozoj gjykatës që kërkesë padinë e paditësit ta miratojë pjesërisht si të bazuar, sepse shumat e kërkuara nga pala paditëse janë shumë të larta dhe nuk janë në harmoni me lëndime e pësuar nga paditësja dhe me praktikën gjyqësore.

Këtyre theksimeve gjykata nuk ua dha besimin dhe kërkesëpadisë së paditësit, e miratoi në tërësi si të bazuar, sepse shumat e kërkuara, ishte në harmoni me lëndimet e pësuar dhe praktikën gjyqësore, po ashtu ishte në harmoni me udhëzuesin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Gj.A 41/2023, i datës 27.02.2023.

Gjykata e detyroi palën e paditur që paditësit të ja paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1073, 00€ edhe atë: 104. € për përpilimin e padisë, 405.€ për 3 përfaqësime nga ana e avokatit, 400.00€ për ekspertizën mjekësore, 104.00€, për precizimin e padisë dhe shumën prej 60.00€, në emër të taksës për padi (të parapara sipas udhëzimit administrativ nr.01/2017 të Këshillit Gjyqësorë), gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e ka bazuar në nenin 452.1, të LPK-së.

Nga sa u theksua më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

Dega në Kaçanik

C.nr.2022:279342 prej datës 20.03.2024

Gjyqtari:

Riza Livoreka

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.

*Dërguar me datën 19.04.2024*

*Të autorizuarit të paditësit 1x1*

*Të autorizuarit të paditurës 1x1*

Numri i lëndës: 2022:279341  
Datë: 19.04.2024  
Numri i dokumentit: 05595750